



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 15.06.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës **12.06.2023**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **Access Solution shpk**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për Njësitë organizative të QKUK-së”** LOT 1, 32, 33, 34, me numër prokurimi **206-23-4215-1-1-1** nxjerr:

V E N D I M

1. **Pranohet** kërkesa për ri-shqyrtim e operatorit ekonomik Access Solution shpk e dt.12.06.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për Njësitë organizative të QKUK-së” Lot 1, 32, 33, 34, me numër prokurimi 206-23-4215-1-1-1, kundër Njoftimit për Kontratë të datës 16.04.2023, të publikuar në platformën elektronike;
2. **Do të rishikohet**, Specifikimi Teknik dhe buxheti për Lot 1, 32, 33, 34;
3. Autoriteti Kontraktues, e shtyn afatin për ofertim për aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik Access Solution shpk me datë 12.06.2023 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për Njësitë organizative të QKUK-së” – Lot 1, 32, 33, 34, me numër prokurimi 206-23-4215-1-1-1. Autoriteti Kontraktues, e ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkëlur nga AK sipas OE Access Solution shpk:

Pretendimet ankimore:

Po ju shkruajme me kërkesën për të rishqyrtuar ndarjen e buxhetit të llotit#1 Lot 1 - Furnizim me pajisje mjekësore për Fertilizim të Asistuar Mjekësor IVF në Kl. e Gjinekologjisë me Obstetrikë. Buxheti i parashikuar për këtë llot para ndarjes në 4 lloje të tjera ka qenë 826,900 euro.

Pas kërkeses se disa OE artikujt e ketij lloti jane ndare ne 4 lloje te ndryshme: Lot#1, Lot#32, Lot#33 dhe Lot#34. Mirepo buxheti per keto lloje mendojme se nuk eshte ndare ne menyre proporcionale sipas vleres se artikujve ne treg.

Buxheti i ndare per Llotin#33 Software for IVF laboratory with scan and bar code reader eshte i pamjaftueshem ndersa buxheti i parashikuar per Llotin#1 dhe Llotin #32 e tejkalon vleren e artikujve ne treg.

Loti#33 pervec softwerit jane kerkuar edhe shume pajisje percjellese qe jane obligative per funksionimin e ketij softweri.

Vlera reale ne treg e ketij softweri se bashku me te gjitha pajisjet e kerkuar ne dosje te tenderit eshte rreth 130000.00, prandaj kerkojme qe te rishrytohet buxheti i llotit#1 dhe llotit#32 dhe nje pjese e buxhetit nga keto lloje te dedikohet per llotin#33 per te plotesuar shumen prej 130000.00 euro.

Demet materiale:

- 1. Vlerat e parashikuara per llotin#1 dhe #32 mbi vlerat reale te tregut mund te hap rruge per keqperdorime te buxhetit nga OE te ndryshem te cilet mund te aplikojne ne vleren e parashikuar dhe**
- 2. Parashikimi me i ulet se vlera e tregut per llotin#33 mund te sjell qe ky llot mte deshtojte ose te ofertohej software jo adekuat me shume mangesi dhe si pasoje puna e Departamentit te IVF do te veshtersohet dhe krijohen mundesi te medha per gabime sepse funksioni i ketij software eshte per menaxhimin e mostrave dhe hapsirave ne kuader te ketij departamenti.**

Pergjigjia e Autoriteteit Kontraktues ne lidhje me pretendimin Ankimore te OE

Pranohen pretendimet ankimore te OE Access Solution shpk.

AK-MSh ne bashkepunim me SHSKUK do t'i rishikoj specifikat teknike te pajisjeve dhe te softwarit.


Zyrtari Pergjegjes i prokurimit bazuar ne ato qe u thane me lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Keshilla juridike:

Kunder ketij vendimi, ankuesi mund te paraqese ankesa pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Vendimi i dorëzohet:

1. Access Solution shpk
2. Operatoreve ekonomik te interesuar


Berat Marmullaku
Zyrtar pergjegjes i Prokurimit